



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 4967/11 Prot.

Tirane, me 26. 8 2016

DEKLARATE MJEDISORE

per Vleresimin Strategjik Mjedisor

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 91, date 28.02.2013 "Per vleresimin strategjik mjedisor" dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij, Ministri i Mjedisit, leshon kete Deklarate Mjedisore per:

Projekti: Plani i Pergjithshem Vendor per Bashkine Shkoder

Kerkuesi: Bashkia Shkoder

Kufijte e zones qe mbulon plani: bashkia Shkoder me siperfaqe 31 km², ku perfshin 11 njesi administrative

Perdorimi i deklarates mjedisore

Deklerata Mjedisore nuk perjashton detyrimin qe per projekte te vecanta te parashikuara ne kete Plan t'i nenshtrohen kerkesave te legjislacionit ne fuqi per vleresimin e ndikimit ne mjedis, per lejet e mjedisit dhe akteve te tjera normative ne fuqi.

Qendrimi i Ministrise:

Plani i propozuar ne parim perputhet me objektivat e mbrojtjes se mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem.

Duke realizuar nderhyrjet e duhura hapesine dhe duke zbatuar te gjitha masat e nevojshme zbutese, te gjitha grup-projektet jane te pranueshme nga kendveshtrimi mjedisor.

Perfshirja efektive e grupeve perkatese te interesit ka kontribouar ne cilesine e vleresimit, ka sjelle te dhena per analizen dhe raportin e VSM-se dhe do te mbeshtese zbatimin e planit pas miratimit te tij, si dhe do te kontribuojte ne nje pranim me te lehte dhe me te zbutur te projekteve perkates.

Ndikimet e mundshme ne mjedis te planit



Gjate zbatimit të projekteve/veprimeve, priten të ndohin impakte pozitive dhe negative. Impaktet positive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatike duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe me tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësive së ajrit dhe cilësive së shëndetit human, midis të tjerave. Për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastruktures në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakesimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në levizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastruktures në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka vecori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastruktures, sidomos atyre me shtrirje të gjera dhe korridoreve sipas sektoreve (transport, energji, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgimie kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave. Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe impaktet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave:

Vlerësimi i përputhshmërisë së politikave të Planit me objektivat mjedisorë tregon se, në përgjithësi, politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisorë në nivele të ndryshme. Nga vlerësimi i përputhshmërisë rezultojnë: Objektivat që përputhen plotësisht janë 3, Objektivat që përputhen pjesërisht janë 11, Lidhja mes objektivave është e zbehtë për 20 prej këtyre objektivave dhe nuk ka lidhje mes objektivave janë 4 prej tyre. Niveli i lidhjes së politikave me objektivat mjedisorë ndryshon në vartësi të fushave mjedisorë. Në këndvështrimin e shqyrtimit të lidhjes mes politikave të Planit dhe objektivave mjedisorë, vërehet një përputhshmeri e ndryshme sipas fushave perkatese mjedisorë. Konkretisht:

Politikat kanë përputhshmeri me të lartë me objektivat e popullsisë, asetëve materiale dhe kohezionit social, me objektivin mjedisor mbrojtja, menaxhimi dhe përdorimi i tokës, politikat e mbrojtjes së mjedisit me objektivat mjedisorë, politikat e cilësive të jetes dhe objektivat mjedisorë. Politikat që lidhen me përmirësimin e Infrastruktures të shërbimeve urbane dhe mjedisin urban dhe ato që lidhen me Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Cilësive së Mjedisit Natyror kanë lidhje me të lartë në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisorë.

Kater politika nuk kanë lidhje me objektivat mjedisorë. Në 22 politika klasifikohet një lidhje e zbehtë me objektivat mjedisorë. Politikat strategjike të përmirësimit të aksesit dhe marrëdhënieve rajonale përputhen me objektivat mjedisorë në kufinj të pjesërisht deri në lidhje të zbehtë. Infrastruktura përputhet pjesërisht me objektivat mjedisorë, duke kërkuar kështu zbatimin e masave mbrojtëse. Objektiva mjedisorë 1 që lidhen me menaxhimin e tokës, dhe objektiva 10 që lidhen me popullsinë, janë në përputhshmeri të plotë me pjesën me

te madhe te politikave te planit. Objektiva 11 qe lidhet me ruajtjen e trashegimise kulturore eshte objektiva qe nuk lidhet me pjesen me te madhe te politikave te Planit.

Si perfundim konstatohet se ne kendveshtrimin e pergjithshem, objektivat dhe politikat e Planit jane ne perputhje me objektivat mjedisore me zbatimin e masave zbutese.

Detajimi i masave per mbrojtjen e mjedisit:

Me qellimin per te shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative ne mjedis te planit ne te gjithe fazat e tij duhet te zbatohen me perpikmeri te gjitha masat e meposhtme.

- Te hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjate zbatimit te planit, me synim mbledhjen e te dhenave per ndikimet konkrete dhe pasojat ne mjedis gjate zbatimit te tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutese shtese, qe duhet te zbatohen per te garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan te hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklarates Mjedisore dhe te merret miratimi i autoriteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit.
- Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit qe zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit te hartoje nje raport vjetor per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit gjate zbatimit, te cilin duhet ta dergoje prane Ministrise se Mjedisit jo me vone se java e fundit e muajit nentor.
- Me qellim lehtesimin e realizimit te programit te monitorimit mjedisor te planit mund te perdoren programe ekzistuese monitorimi, qe perputhen me qellimin e programit te monitorimit mjedisor te planit.
- Projektimi i objekteve te bazohet ne parimin e teknologjise me te mire te disponueshme, e cila eshte eficiente ne perdorimin e energjise, si perdorimi i teknologjive izotermike te ndertimit per cdo objekt te ri po keshtu edhe ato te minimizimit te perdorimit te ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukture te parashikuara ne Plan te sigurojne kohezion, efikasitet dhe qendrueshmeri, dhe rritjen e perfitimeve per perdoruesit e kesaj infrastrukture.
- Plani duhet te nxite realizimin e projekteve te impianteve te trajtimit te ujrave te perdorur urbane dhe ne nje shkalle me te gjere duke e shtrire kete mase edhe ne aktivite e tjera industriale qe krijojne shkarkime ujrash industriale te ndotura dhe qe ndikojne sidomos ne cilesine e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore. Te projektohet infrastrukture bashkekohore dhe afatgjate te kanalizimeve te ujerave te ndotura urbane.
- Te mbrohen vlerat natyrore te zonave ne te cilat shtrihet studimi dhe te shmangen ne maksimum demtimi i siperfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet te projektohen ne harmoni me kuadrin ligjor per mbrojtjen e natyres, duke respektuar shkallen e mbrojtjes se zones apo nenzones se mbrojtur ku do te nderhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve qe gjenden ne zone, si dhe te komunikohet/bashkepunohet me AdZM per te marre masat e domosdoshme per mos cenimin e statusit te ketyre zonave.
- Gjate fazes se projektimit dhe sidomos perpara nisjes se fazes se zbatimit te projekteve/aktiviteve specifike individuale te Planit duhet te perfshihen masa qe do te

lehtesojne ruajtjen e korridoreve te kafsheve migratore. Ne rastin kur projektet qe do zbatohen mund te prekin zona te Mbrojtura apo mund te ndodhen ne afersi te tyre.

- Plani te marre masa per promovimin e transportit publik te pasagjereve qe te kontribuojne ne pakesimin e shkarkimeve ne ajer.
- Te zbatohen masa zbutese per zhvillimin e infrastruktures, gjate rehabilitimit/ndertimit duhet te parashikojne edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar „best practices“. Ne asnje rast nuk duhet te projektohet brenda, por as ne afersi te territorit te zonave te mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet ne ajer dhe zhurmat ndikojne ekosistemet dhe habitatet e llojeve nen mbrojtje. Promovimi brenda dhe ne periferite e zonave te mbrojtura duhet te jete ngritja e infrastruktureve te lehta qe mbeshtesin aktivitetet pa makina, ne drejtim te sporteve dhe aktiviteteteve ne natyre.
- Hartimi i planeve te menaxhimit te trafikut krahas prioritizimit te zonave te gjelberta publike, duhet te paraprijne planet urbane te zhvillimit dhe te kene objektiva te matshme per cilesine e ajrit.
- Te merren masa per mbrojtjen dhe mos demtimin e burimeve ujore qe gjenden ne zonen ne studim.
- Ne kuader te planifikimit te menaxhimit, vemendje e vecante te kushtohet per integrimin e zonave te sigurise nga permbytjet dhe atyre ligatinore, nderkohe qe masat e pyllzezimit te synojne stabilizimin e humbjeve e tokes nga permbytjet (te zbatohet duke perdorur lloje te bimesise autoktone qe i rezistojne edhe permbytjeve).
- Para fillimit te zbatimit te projekteve te zgjidhet ceshtja e administrimit te volumit inert qe do te gjenerohet nga operacionet ndertimore.
- Plani duhet te parashikojte kapacitete me te medha per landfillet ekzistuese dhe se pari ndertimi i landfilleve te reja teknologjike duhet te paraprije investimet ne kete.
- Ne teresi, projektet specifike duhet te projektohen ne harmoni me standartet e ruajtjes se peisazhit dhe mbrojtjen e trashegimise kulturore, ku se bashku me elementet e cilesise se mjedisit te jene paresore duke aplikuar „best practices“.
- Gjate implementimit te planit te vihen ne zbatim masat zbutese te propozuara ne raportin e VSM-se per minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative ne mjedis.

Detyrime dhe sanksione:

- › Pavarsisht masave dhe rekomandimeve te kesaj Deklarate Mjedisore, gjate zbatimit te planit eshte e detyrueshme te zbatohen kerkesat e legjislacionit mjedisor ne fuqi;
- › Shfaqja e elementeve te rinj ekologjike te panjohur, ne kohen qe kjo Deklarate Mjedisore eshte dhene, sjell si detyrim rivleresimin e saj.
- › Nese plani nuk eshte miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit te deklarates, atehere deklarata behet e pavlefshme dhe procedura e VSM-se fillon nga e para.
- › Ne rast se ministria, strukturat e saj te varesise, njesite e qeverisjes vendore apo edhe grupet e interesuara, perfshi edhe publikun, konstatojne se plani nuk zbatohet ne perputhje me vendimin per miratimin e tyre dhe nuk respektojne kushtet e kerkesat e percaktuara per mbrojtjen e mjedisit, atehere ministria njofton menjehere autoritetin



pergjegjes per zbatimin e miratimin e planit dhe, sipas rrethanave, i kerkon sqarimet perkatese apo ndalimin e menjehershëm te zbatimit deri ne sqarimin e situates.

Nese pasojat ne mjedis e shendet, tejkalojne standardet mjedisore ne fuqi, atehere ministria i kerkon autoritetit miratues e propozues te merren masat e duhura apo te konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qellim qe te permbushen standardet mjedisore.

- › Per mos respektimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo Deklarate Mjedisore dhe te legjislacionit mjedisor ne fuqi ka sanksione ligjore.

Lefter KOKA



MINISTRI

